

POP 5Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1

2

3


4

5

Kronikë

Tiranë/ Policia shkon ta riarrestojë 29-vjeçarin për thyerjen e masës së Gjykatës, në banesë i gjen pjesë armësh dhe municione!

I riu kishte thyer masën “arrest shtëpiak” të vendosur nga Gjykata e Tiranës, për largim nga vendi i qëndrimit, por efektivët në banesë i zbuluan gjatë kontrollit edhe pjesët e armëve dhe municionin luftarak



[Sh] Redaksia 27 Gusht, 13:14 | Përditësimi: 27 Gusht, 13:17 Share WhatsApp

A A

Tiranë- Theu masën e arrestit të vendosur nga Gjykata e Tiranës, riarrestohet 29-vjeçari, të cilit gjatë kontrollit të shtëpisë iu gjetën edhe armatim dhe municione.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit Nr. 3 bënë me dije sot (27 gusht) se kapën dhe ekzekutuan vendimin e Gjykatës për të riun me dy identitete, F. D(P).

“Ndaj tij është vendosur masa e sigurisë “arrest me burg” për veprën penale “largim i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”. Gjatë kontrollit të banesës iu gjet municion luftarak dhe pjesë arme të dyshuara zjarri”, njoftoi policia e kryeqytetit pas aksionit.

LEXO EDHE:
“Avujt” e alkoolit në timon, këtë vit shoferët e dehur 19 aksidente me 7 viktime (DETAJET e ndëshkimeve)

Për ngjarjen po heton edhe Prokuroria e Tiranës, pasi po verifikohet edhe nëse i riu është pjesë e ndonjë grupi kriminal apo të shitjes së armëve e municionit.

A.Q/Shqiptarja.com

TAG: Tirane arme zjarri Gjykata e Tiranës Komisaritati nr. 3

Komento

Komente

Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH
Sondazhi i ditës:
Aksidentet e rënda rrugore, a duhen ashpërsuar dënimet në Kodin Penal?

Po Jo Nuk kam mendim

26 Gusht, 10:57

Lajme të tjera